



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 14 të Ligjit mbi tokën ndërtimore ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 14/80 dhe 42/86), nenit 3, al. 1, pika "b" të Rregullores për vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, nenit 7 të Rregullores për dhënie të tokës ndërtimore në shfrytëzim të përkohshëm për ndërtimin-vendosjen e objekteve të përkohshme nr. 01.-01.-2, të datës 03.01.2002 dhe nenit 19, al. 1, pika "b" të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 10.08.2004 merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT DHE DHËNIEN E TOKËS NË SHFRYTËZIM
TË PËRKOHSHËM SHOQATËS HUMANITARE BËMIRËSE TË KOSOVËS
"NËNA TEREZË"

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e depos për nevojat e shoqatës humanitare bëmirëse "Nëna Terezë" në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni, nga neni 1 e këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 1504/6, zona kadastrale e Prishtinës, në sipërfaqe prej 30 ari, në Prishtinë.

Neni 3

Lokacioni, nga neni 1 i këtij Vendimi, i jepet në shfrytëzim të përkohshëm shoqatës humanitare bëmirëse "Nëna Terezë" në kohëzgjatje prej 1 viti, me mundësinë e vazhdim të kësaj të drejte edhe pas kalimit të këtij afati.

Mënyra, të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga shfrytëzimi i lokacionit të caktuar, sipas këtij vendimi, do të rregullohen me kontratë të veçantë në mes të Komunës dhe shfrytëzuesit.

Neni 4

Kushtet urbanistiko-teknike dhe lejimin e vendosjes së objektit në lokacionin e caktuar, sipas këtij Aktvendimi, do t'i caktojë Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, i Komunës së Prishtinës është përgjegjës për kryerjen e veprimeve procedurale nga përgjegjësia e tij për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës

Neni 6

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është edhe pjesa grafike e situacionit të lokacionit, nga neni 2 i këtij Vendimi.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. NR. 353-2142 DT. 11.08.2004

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri